



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:256951

Datë: 28.03.2023

Numri i dokumentit: 04129041

2022:272284

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, dhe me bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit F.H., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1698/22, të datës 17.12.2022, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 28.02.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarve E.A. dhe D.A., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Zekrija Gashi, po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 13.03.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: **F.H.** i lindur më datë në... nga i ati G., dhe e ëma F., e gjinis H., me vendbanim në fshatin, K. Shtime, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion moler, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase i Republikës së Kosovës, me numër personal, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë 16.10.2022, rreth orës 19:40 h, në aksin rrugor nga drejtimi i Restorant “.....” në drejtim të rrugës nacionale Ferizaj -Shtime tek vendi i quajtur “P.” Komuna Shtime, i pandehuri deri sa kishte qenë duke drejtuar automjetin e tipit “VW.GOLF ” me ngjyrë të bardhë me targa të regjistrimit, nga pakujdesia e në kundërshtim me Ligjin për rregullat e trafikut rrugor saktësisht të nenit 53 dhe 231 ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që

duke mos përshtatur shpejtësinë, kushteve, llojit dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes psikofizike dhe aftësive të tij ,nuk ka mundure në mënyrë të sigurt ta kontrollon automjetin nëpër shiritin përkatës të lëvizjes dhe si rezultat i kësaj shmanget nga ana e djathtë jashtë rrugës dhe me derën e djathtë të pasme të automjetit përplasat në një shtyllë elektrike të betonit, me ç rast lëndime trupore pësojnë të dëmtuarit pasagjeret, E.A. dëmtime të rënda trupore dhe atë: thyerje e kockës së hundës me zhvendosje të frakmenteve ndërsa i dëmtuari D.A. pëson dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkoshëm për shëndetin të përshkruara si në akt-ekspertizën me numër Ref: Fe-..... të datës 18.11.2022,-

- **me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni- 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 44, 69 ,70, dhe 370 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452, 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 700 € / shtatëqind euro/, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e pagueu dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzet Euro/ për shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) shumë prej 20 €,njëzet Euro / si dhe (ekspertiza e komunikacionit) shumë prej 100 Euro / njëqind Euro/, të gjitha në afatin prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Po ashtu i pandehuri obligohet, konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej 20 € /njëzet euro/, brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit E.A. dhe D.A. që të dy nga fshati.... Komuna Shtime, kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1698/22, të datës 17.12.2022, ka ngarkuar të pandehurin, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitura për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 28.02.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, të dëmtuarit dhe i pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, për rastin që më ka ndodhur

jam i penduar, ju kërkoj falje të dëmtuarve për lëndimet trupore që u kam shkaktuar në këtë rast, premtoj se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe lus gjykatën që të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur pasi që për herë të parë kam ra ndesh me ligjin.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Zekrija Gashi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i pandehuri e pranon fajësinë meqenëse aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia dhe për shkaqe objektive dhe moshës së re i njëjti pendohet për atë që ka ndodhur, i propozojmë gjykatës që të nxjerr aktgjykim në bazë të pranimit të fajësisë sepse ky pranim bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale për të cilën akuzohet, në bazë të nenit 242 paragrafi 5 të KPPRK-së, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, i cili deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje me dispozitat e nenit 242 të KPPK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj sanksion penale sipas ligjit, përkitazi për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë rrezikshmërisë dhe pasojën e shkaktuar nga kjo veprë penale.

I dëmtuari E.A. lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk ushtrojë kërkesë pasurore juridike pasi që me të pandehurin jemi shokë dhe aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia.

I dëmtuari D.A. lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk ushtrojë kërkesë pasurore juridike pasi që me të pandehurin jemi shokë dhe aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës të tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit

konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, Raporti mbi Aksidentin me numër 2022-..... i datës 16.10.2022, Skica e vendit të ngjarjes me numër 2022-CFT-.... e datës 16.10.2022, Raporti i Policisë hetues me numër 2022-CFT-.... i datës 16.10.2022, Deklarata e të pandehurit F.H. të dhënë në PTH në Ferizaj me 13.12.2022, Deklarata e të dëmtuarit E.A. të dhënë në PTH në Ferizaj me 13.12.2022, Deklarata e të dëmtuarit D.A. të dhënë në PTH në Ferizaj me 13.12.2022, Mendimi dhe konstatimi i Ekspertit të komunikacionit rrugor i datës 14.12.2022, Ekspertiza Mjeko-ligjore Nr.Ref Fe-.... të datës 18.11.2022, nga Dr. D.H., Raporti mjekësorë lëshuar nga Klinika Emergjente-QKUK-Prishtinë me nr. të datës 16.10.2022 në emër të E.A., Raporti mjekësorë lëshuar nga Klinika Emergjente-QKUK-Prishtinë me nr.... të datës 16.10.2022 në emër të D.A., Foto-dokumentacioni mbi vendin e ngjarjes si dhe Shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e sigurtë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit veprën të tillë apo të ngjashme, se për herë të parë ka rëndesh me ligjin, se të dëmtuarit nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale e as nuk kanë paraqitur kërkesa pasurore-juridike, është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rastin konkret

nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjesisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe shpenzimet e procedurës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.1 lidhur me nenin 449 par.2 nen par.2.6 të KPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2022:272284, e datës 13.03.2023**

Bashkëpunëtori profesional:

Driton Ahmeti

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.